**VENDIM**
**Nr. 145, datë 19.7.2024**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË "RREGULLOREN PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE-s, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, pika 1, 16, pika 3 dhe 27, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 5, pika 23 dhe 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe pikës 6.2, të pjesës IV (Dispozita përfundimtare) të "Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 197/6 prot., datë 18.7.2024 të përgatitur nga grupi i punës "Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në 'Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes', miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, të ndryshuar",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendim nr. 43, datë 29.3.2024, ndër të tjera vendosi: "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në 'Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes', miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, të ndryshuar".

- Vendimi i sipërcituar dhe propozimet e OSSH sh.a. për ndryshime në rregulloren objekt shqyrtimi është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 69, datë 22.4.2024, në faqen zyrtare të internetit të ERE-s https://ere.gov.al/sq/, përkatësisht në zërat "Vendime" dhe "Konsultime".

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 660/7 prot., datë 22.5.2024, dhe shkresës nr. 660/2 prot., datë 8.4.2024, ka njoftuar shoqërinë OSSH sh.a. dhe palët e interesit: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Autoritetin e Konkurrencës (AK), Avokatin e Popullit (AP), Ministrinë e Financës (MF), Shoqatën e Konsumatorit Shqiptar, Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA), Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit, Shoqatën Konsumatori në Fokus dhe Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit, mbi procedurën e konsultimit publik, përshirë dhe afatet e mundshme për depozitimin e komenteve.

- Në përfundim të procesit të konsultimeve, disa nga palët e interesit janë shprehur si vijon:

- Me shkresën nr. 660/8 prot., datë 23.5.2024, AP-ja është shprehur se: "... nga konsultimi me draftrregulloren e publikuar në faqen zyrtare të internetit www.ere.gov.al, ka konstatuar se propozimet e bëra lidhur me ndryshimet në këtë rregullore në tërësinë e tyre, rezultojnë të jenë në frymën e ligjit, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve pranë konsumatorit, kontrollin e shërbimeve që ofron i licencuari ndaj konsumatorit, promovimin e konkurrencës së mbrojtjes së konsumatorit, informimin e konsumatorit për të mbështetur të drejtat e tyre të zgjedhjes së furnizuesit të energjisë elektrike".

- Me shkresën nr. 660/9 prot., datë 27.5.2024, MIE është shprehur dakord me propozimet e paraqitura nga OSSH sh.a., në "Rregulloren për lidhjet e reja në rrjetin e shpërndarjes, nëpërmjet të cilave synohet unifikimi i cilësisë së punimeve, standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe rritja e eficiencës në ofrimin e këtij shërbimi nga OSSH sh.a.

- Me shkresën nr. 660/5 prot., datë 13.5.2024, ISHTI bën me dije se është dakord në parim me ndryshimet e propozuara nga ana e OSSH sh.a., duke kërkuar që kjo rregullore të jetë në përputhje edhe me: i. VKM-n nr. 245, datë 30.3.2016, "Për miratimin e rregullës teknike për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e diapozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike", dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara; ii. VKM-në nr. 482, datë 17.6.2020,

"Për miratimin e rregullës teknike për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV", si dhe iii. VKM-në nr. 483, datë 17.6.2020, "Për miratimin e rregullës teknike për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 kV". ISHTI argumenton se është e nevojshme për subjektet e kësaj rregulloreje për të bërë regjistrimin pranë këtij institucioni si kusht ligjor përpara vënies në shfrytëzim, duke sqaruar, se: trajtimi në "Rregulloren e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes, i detyrimit të subjektit për të bërë regjistrimin pranë ISHTI-it, si kusht ligjor përpara vënies në shfrytëzim (dhënies tension) do të lehtësonte dhe do të jepte vlerë në këtë proces. Deklarata e konformitetit, projekti elektrik, kontrata e mirëmbajtjes, certifikata e inspektimit fillestar etj., si vetëdeklarim i subjektit, mund të kërkohen ose jo nga OSHEE-ja, ndërsa si detyrim ligjor ato duhet të dorëzohen pranë ISHTI në procesin e regjistrimit përpara vënies në shfrytëzim. Në këtë kuptim, regjistrimi pranë ISHTI-t si kriter në Rregulloren e Lidhjeve të Reja që ju po trajtoni, do të ishte ndihmë dhe për OSH-nëë, pasi do të ishte një proces sigurie elektrike i kryer nga ISHTI, në përputhje me pjesën procedurale të OSHEE-së.

- Lidhur me sa propozohet si shtesa e ndryshime nga ana e ISHTI-t në "Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", të ndryshuar, vlerësohet se nuk duhet të merren në shqyrtim në përfundim të kësaj procedure administrative, e cila ka filluar për tjetër objekt dhe për të tjera shtesa e ndryshime.

- Në përfundim të procesit të konsultimeve, në zbatim të parashikimeve të pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 43/2024, OSSH sh.a. ka përcjellë, sqarimet e nevojshme për të argumentuar shkakun ligjor për propozimin e secilit ndryshim apo shtesë, me shkresën me nr. 660/10 prot., datë 14.6.2024, duke sqaruar sa vijon:

- Lidhur me propozimin për ndryshimin e paragrafit 1.3 "Përkufizime", ku është kërkuar të hiqet përkufizimi "Tarifa për aplikim (pagesa) është pagesa që kryhet nga aplikanti në kohën kur aplikohet për lidhje, e cila mbulon studimin e pranueshmërisë së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes dhe përgatitjen e dokumentacionit për hartimin e marrëveshjes së lidhjes..." dhe përkufizimi "Tarifa për mbikëqyrje dhe tarifa për kolaudim janë tarifa për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikëqyrjen e ndërtimit, testimit dhe kolaudimit të lidhjes, të cilat paguhen nga aplikanti", ndryshon dhe bëhet: "Tarifat e verifikimit dhe të kolaudimit fillestar të matësit janë tarifa për azhurnimin e rrjetit, shpenzime administrative dhe kolaudim fillestar i matësve të energjisë elektrike:

- Lidhur me këtë propozim vlerësohet, se: "nuk qëndron i argumentuar dhe si pasojë termi i përdorur "Tarifa e verifikimit dhe kolaudimit fillestar të matësit" janë tarifa për azhurnimin e rrjetit, shpenzime administrative dhe kolaudim fillestar i matësve të energjisë elektrike, nuk është në përputhje me qëllimin për të cilin bëhet ndryshimi. Gjithashtu, ligji nr. 43/2015, i ndryshuar, në nenin 77, pika 8, parashikon që: "Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për energjinë". Në këtë kuptim janë aktet e tjera nënligjore, të cilat rregullojnë tarifat. Për pasojë vlerësohet që ky ndryshim të ketë emërtimin "Tarifë aplikimi", me përmbajtje: duke ndryshuar përmbajtjen nisur nga fakti që tanimë kjo tarifë të paguhet pas miratimit të preventivit.

- Lidhur me propozimin "Kudo në rregullore dhe anekse ku është përdorur termi "OSHEE" sh.a., do të ndryshohet me "OSSH" sh.a." vlerësohet që ai të pranohet sipas emërtimi/statusit ligjor të shoqërisë, e cila ka tagrin ligjor për propozimin dhe për zbatimin e ndryshimeve.

- Në paragrafin 1.3 "Përkufizime" është propozuar të shtohet përkufizimi me përmbajtje: "Lidhje e përkohshme" është lidhje e energjisë elektrike, e cila hapet vetëm për subjekte sezonale për periudha të caktuara sipas kërkesës së aplikantit.

- Lidhur me propozimin për përkufizimin e termit "Lidhje e përkohshme", nga ana e shoqërisë OSSH sh.a., ndër të tjera është dhënë sqarimi (i cili përkon dhe me propozimin për shtesën e pikës 2.1.1 në Rregullore), si vijon: "Lidhjet e përkohshme do t'u ofrohen objekteve sezonale (të përkohshëm), si: kashtore, kioska, beach-bar, eventet festive, panairet etj., në mënyrë që lidhja e tyre me rrjetin e shpërndarës të OSSH sh.a., të kryhet në procedurë të rregullt, por të përshpejtuar për të

shmangur informalitetin dhe mundësinë e vjedhjes së energjisë. Duke qenë objekte të përkohshme, këto objekte nuk janë të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të kërkuara, për një lidhje të re, gjë që sjell në vonesa ose refuzime të lidhjes së re. Në këtë formë mund t'i jepet një zgjidhje që të njihen si lidhje të përkohshme dhe në momentin e mbarimit të aktivitetit të tyre sezonal/turistik/festiv të bëhet pezullimi apo mbyllja e kontratës së energjisë elektrike. Tarifat që do të paguhen për lidhjen e re do të jenë të njëjta me tarifat e miratuara në rregullore referuar fuqive të kërkuara si dhe mbyllja apo pezullimi i këtyre kontratave do të kryhet me të njëjtën procedurë që parashikon kontrata e furnizimit me energji elektrike.

- Sa i përket këtij përkufizimi, vlerësohet të pranohet, duke saktësuar qëllimin apo momentin e mbarimit të aktivitetit të përkohshëm dhe si do të veprohet në rastet e përfundimit të kontratës së energjisë elektrike. Për pasojë përkufizimi i lidhjes së përkohshme duhet saktësuar, me qëllim përcaktimin e ushtrimit të aktivitetit brenda një periudhe kohore, të përcaktuar rast pas rasti nga organet të cilat kanë në kompetencë lëshimin e lejeve zhvillimore apo lejeve të ndërtimit të përkohshëm.

- Afati i "Lidhjes së përkohshme" duhet të përkojë dhe të jetë i njëjtë me afatin/afatet e lejes zhvillimore ose lejes së ndërtimit të përkohshëm. Gjithashtu, vlerësohet se me përfundimin e afatit të lejeve të sipërcituara, subjekti duhet të aplikojë për një lidhje të re të përkohshme në momentin që ndodh demontimi nga organet kompetente, të objektit i cili ka një leje zhvillimore apo leje ndërtimi të përkohshme në fuqi. Kjo ka për qëllim dhe shmangien e kostove për lidhjet e reja, nëse objekti do të ripërdoret përsëri nga aplikanti, i njëjtë apo i ndryshëm, i cili ka përfituar një leje zhvillimore apo leje ndërtimi të përkohshme. Për këto arsye, vlerësohet të riformulohet termi "Lidhje e përkohshme", si vijon: Lidhje e përkohshme është lidhja e energjisë elektrike, e cila hapet vetëm për subjekte sezonale për periudha të caktuara, sipas kërkesës së aplikantit, në përputhje me afatet dhe lejen zhvillimore apo lejen e ndërtimit të përkohshme.

- Vlerësohet që nga pikëpamja e teknikës legjislative, të reflektohen në një grup të posaçëm dispozitash, të cilat të reflektojnë veçmas kushtet, procedurat dhe afatet të cilave u nënshtrohen aplikuesit për një lidhje të përkohshme, si dhe të drejtat e detyrimet të cilave u nënshtrohet kjo kategori. Ato janë sjellë, në harmoni me dispozitat e "Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, sa u përket lidhjeve të zakonshme, duke reflektuar parashikimet e posaçme që i përkasin kësaj kategorie të re, si vijon:

- Aplikimi për lidhje të re të përkohshme në sistemin e shpërndarjes mund të kryhet nga:

a) Çdo person fizik apo juridik, apo përdorues ekzistues, i tillë që ushtron aktivitet sezonal të përkohshëm, në përputhje me një leje zhvillimore apo leje ndërtimi të përkohshme, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në aktmarrëveshjen ndërmjet përdoruesit të përkohshëm dhe OSSH sh.a.;

b) Tarifat që do të paguhen për lidhjen e re të përkohshme do të jenë të njëjta me tarifat e miratuara në rregullore, referuar fuqisë së instaluar të kërkuar;

c) Pezullimi apo mbyllja e kontratës për lidhjen e re të përkohshme do të kryhet me të njëjtën procedurë që parashikon kontrata e furnizimit me energji elektrike ose rastet kur ka përfunduar leja zhvillimore/e ndërtimit e përkohshme e lëshuar nga organet kompetente apo jemi në kushtet e demontimit të objektit nga organet ligjzbatuese.

- Lidhur me paragrafin 1.5 të rregullores, në të cilin është propozuar për t'u shtuar germa "c", si vijon: "(...) dhe furnizuesit. Në rast se në një objekt ka një kontratë ekzistuese nuk mund të aplikohet për lidhje të re, por vetëm për modifikim të lidhjes ekzistuese (në rastet kur kemi vetëm një dokument pronësie). Në rast se kërkohet që të lidhet një kontratë e re kjo do të aplikohet vetëm nëse objekti është i ndarë në ambiente të ndryshme, të ndara në mënyrë të dukshme, dhe kur lidhja e re që kërkohet ka një kategori të ndryshme nga kontrata ekzistuese.

- Vlerësohet se ky propozim nuk është në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, konkretisht nenin 3, pika 1, ku parashikohet, se: "Aksesi i palëve të treta" është e drejta e të gjithë përdoruesve të sistemit për përdorimin e rrjetit të transmetimit

dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, bazuar në kushte të përcaktuara dhe të publikuara, në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara nga ERE, dhe në vijim neni 29, gjithashtu, nuk parashikon kufizime për aksesin në rrjet, siç propozohet nga ana e OSSH sh.a. Ligji, në mënyrë të shprehur, në pikën 2 të këtij neni parashikon mundësinë e refuzimit të aksesit në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në rast se mungon kapaciteti i nevojshëm.

- Vendimi për refuzimin e aksesit në rrjet duhet të jetë i arsyetuar, të bazohet në kushte teknike dhe ekonomike objektive dhe duhet të marrë në konsideratë detyrimin e shërbimit publik, si dhe detyrimet për mbrojtjen e klientëve fundorë, të përcaktuara nga ky ligj. Po ashtu, në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 15, datë 10.1.2018, parashikohet, se: "Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike çdo person jodebitor ndaj furnizuesit universal, që ka një pikë lidhje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në ligjin e Sektorit të Energjisë Elektrike."

- Në këtë frymë edhe në pikën 1.5, germa "a", të "Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes parashikohet, se: "Çdo person fizik apo juridik, i cili aplikon për realizimin e një lidhje të re në Sistemin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (aplikanti), në përputhje me detyrimet e përcaktuara në aktmarrëveshjen ndërmjet përdoruesit dhe OSSH-së".

- Është e qartë që kufizimet, sa i përket së drejtës për akses në rrjet lidhen vetëm me entitetin juridik (individ apo subjekt juridik) që aplikon për lidhje të re apo kontratë furnizimi në vijim, dhe jo me objektin fizik, strukturën në të cilën lidhet një apo më shumë lidhje të reja apo kontrata furnizimi. Për sa më sipër, vlerësohet se integrimi i një parashikimi të tillë është kufizues dhe jo në përputhje me frymën e ligjit, për pasojë, ky propozim nuk pranohet.

- Lidhur me propozimin që në paragrafin 1.6 "Kërkesa për lidhje të re", të shtohet germa "dh" vetëprodhuesit.

- Vlerësohet se ky propozim është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ku në nenin 20, pika 1, përcaktohet se: "vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme kanë një kapacitet maksimal prej 500 kw dhe kanë të drejtë të gjenerojnë, të konsumojnë, të ruajnë dhe të shesin prodhimin e tepërt të energjisë elektrike të rinovueshme (...).

- Lidhur me propozimin për paragrafin 1.11 "Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike të objektit të aplikuesit", germat "b", "c" dhe "e", ku kërkohet të shtohet fjalia "me anë të vetëdeklarimit, apo dokumentacion tjetër", forma e vetëdeklarimit, me disa qartësime është përcjellë nga OSSH sh.a. në vijim. Këtë sqarim e gjejmë të reflektuar në rregullore në pikën 1.11, germa "c", si vijon: Përdoruesi apo aplikanti do të marrë përsipër të çlirojë nga çdo lloj përgjegjësie Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, për çdo lloj detyrimi që lidhet me dëmtime të çdo lloji të rrjetit shpërndarës, të shkaktuara prej instalimeve të brendshme të pajisjeve elektrike në objektin që kërkohet të lidhet me energji elektrike me anë të vetëdeklarimit, apo dokumentacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm po jo i detyrueshëm, prej tij ose paraqitjes së dokumentacionit që kërkohet aktualisht.

- Sa i përket propozimit që lidhet me përgjegjësi individuale për përmbushjen e standardeve të cilësisë së instalimeve të brendshme, gjykohet që, me qëllim që sa propozohet, të mos bjerë ndesh me parashikime të tjera të rregullores objekt shqyrtimi, siç është germa "c" e këtij paragrafi, vlerësohet se deklarimi i propozuar duhet të ndryshohet, me qëllim që të ofrojë thjeshtim të procedurave, njëkohësisht duke e saktësuar, me përjashtim të tekstit i cili përcakton gjeneralitetet e aplikantit, apo të dhëna të tjera në lidhje me instalimet dhe tokëzimin e objektit, si dhe me të dhëna për inxhinierin elektrik/studion sikurse parashikuar në aneksin I të këtij vendimi.

- Për sa më sipër, vlerësohet që të pranohet pjesërisht propozimi për ndryshime në këtë germë duke e njohur formën e vetëdeklarimit si pjesë integrale të rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes (aneksi 1 i rregullores).

- Lidhur me propozimin për paragrafin 1.12 "Mënyra e komunikimit", ku propozohet të shtohet fjalia: "Aplikimi mund të bëhet edhe *online* nëpërmjet aplikacionit në faqen zyrtare të shoqërisë OSHEE Group sh.a., si dhe nëpërmjet aplikacionit mobile" gjatë të cilit do të gjenerohet një numër reference me anë të të cilit është e mundur gjurmimi i hapave të procesit. Njoftimi për aplikim me detajet përkatëse bëhet dhe me anë të *e-mail*-it.

- Lidhur me këtë propozim, grupi i punës vlerëson se një modalitet operimi i tillë jo vetëm që shkurton kohën e lehtëson procedurën e aplikimit, por edhe krijon siguri të mjaftueshme për gjurmimin e stadeve të trajtimit të kërkesës për lidhje, duke lejuar konsumatorin të ndjekë në vazhdimësi ecurinë nëpërmjet komunikimeve elektronike me operatorin përgjegjës.

- Lidhur me pjesën II "Dokumentacioni i kërkuar për aplikimin e një lidhje të re", paragrafi 2.1 "Fuqia e instaluar 0–20 kw" ku propozohet të hiqen pika 4 "Fotokopje e certifikatës së regjistrimit", 5 "Genplani i vendndodhjes së objektit ..." dhe 6 "Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi ..." dhe të zëvendësohen me "Vetëdeklarim nga aplikanti":

"- Sa i përket propozimit në vetvete, që lidhet me përgjegjësi individuale për përmbushjen e detyrimit për kryerjen e instalimeve të brendshme dhe tokëzimit të objektit, vlerësohet se sa propozohet, si pjesë e formës së vetëdeklarimit, i shërben konsumatorit si garanci për të shmangur rrisqe potenciale, me të cilat mund të përballet në të ardhmen, si rrjedhojë e përgjegjësisë ligjore për përmbushje të kushteve teknike. Konkretisht, formulari i vetëdeklarimit, mes të tjerave, ka parashikuar si vijon: Unë _____ deklaroj, që të gjitha instalimet brendshme dhe tokëzimin e objektit i kam bërë me inxhinier elektrik/studio të licencuar, konform kushteve teknike dhe rregullores së shfrytëzimit teknik ...".

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që të pranohet propozimi për ndryshime në këtë dispozitë, duke e njohur formën e vetëdeklarimit (të ndryshuar) si pjesë e aneksit I të rregullores (Marrëveshja e lidhjes). Ndryshimet në formën e deklaratës kryesisht konsistojnë në saktësimin e terminologjisë së përdorur sa vijon: mbikëqyrjen dhe të gjitha instalimet e brendshme i kam bërë me inxhinier (...). Gjithashtu, për sa i përket terminologjisë së përdorur, në lidhje me transferimit e kontratës, vlerësohet se ky veprim është për rastet kur konsumatori bën transferim kontrate pa qenë i nevojshëm aplikimi (pagesa/tarifa që lidhet me një pikë lidhjeje të re). Në këtë rast, disa nga tarifat nuk do jenë të aplikueshme.

- Lidhur me propozimin për pikën 4, e cila kërkohet që të hiqet dhe në paragrafin 2.2, "Fuqia e instaluar 20–50 kw", 2.3 "Fuqia e instaluar 50–100 kw" dhe "Për lidhje të reja në TM", vlerësohet që përderisa certifikata e regjistrimit është një dokument i tepërt në një kohë që me NUIS, OSSH sh.a., mund ta gjenerojë nga QKB-ja direkt çdo lloj informacioni të nevojshëm për aplikimin, vlerësohet që ky propozim të pranohet. Dokumenti "Fotokopje e certifikatës së regjistrimit" të hiqet kudo ku është përmendur në ""Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes".

- OSSH sh.a. ka propozuar, gjithashtu, që paragrafi "Për lidhje të reja në TM", do të numërtohet 2.4. Në këtë paragraf, pika 5, "Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi", propozohet të shtohet me "(...) edhe projekti elektrik i kabinës dhe linjës".

- Lidhur me propozimin e pikës 5, vlerësohet se pjesa e shtuar nuk është e argumentuar dhe nuk i shërben lehtësimit të procedurave dhe qëllimit në vetvete të ndryshimeve në rregullore, përshirë këtu dhe uljen e kostove të mundshme. Gjithashtu, meqenëse parashikimi aktual në rregullore, përkatësisht projekti elektrik, e ka të përfshirë projektin e kabinës ose linjës apo dhe objekte të tjera që mund të lidhen, vlerësohet që propozimi në pikën 5 nuk është i argumentuar.

- Lidhur me ndryshimin në pjesën III "Procedurat e aplikimit për një lidhje të re", paragrafi 3.1.1 "Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulet për fuqi të instaluar 0–20 kw", ku në germën "a" propozohet të bashkohen pika "i" dhe "ii" në vetëm një pikë "i", si vijon: "në jo më shumë se 20 ditë pune"; dhe

- Propozimin që në të njëjtin paragraf, germa "c", llogarit kostot për lidhjen e re, të shtohet fjalia si vijon: "Pagesa e preventivit duhet të shlyhet nga aplikanti brenda 7 ditëve pune nga marrja e njoftimit. Në rast të kundërt aplikimi refuzohet dhe duhet të ri aplikohet".

- Vlerësohet se propozimi për ndryshim i shërben lehtësimit të procedurës, kuptimit të drejtë dhe orientimit të aplikantit, në lidhje me procedurat dhe afatet, për sa u takon lidhjeve të reja ose modifikimit të lidhjeve ekzistuese në tension të ulët për fuqi të instaluar 0–20 kw. Gjithashtu, dhe afatet e parashikuara si në rastin e shqyrtimit të aplikimit, por dhe në rastin e pagesës që duhet shlyer nga aplikanti, janë afate të arsyeshme dhe nuk ngarkojnë paraprakisht aplikantin me kosto shtesë në rast refuzimi.

- Lidhur me paragrafin 3.5, "Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese", i cili propozohet të ndryshohet dhe ndahet në pikën 3.5.1, "Burimet gjeneruese hidro", pikën 3.5.2, "Burimet gjeneruese fotovoltaike" dhe pikën 3.5.3, "Burimet gjeneruese eolike".

- Propozimi ka gjetur reflektim në rregullore në paragrafin 3.5, "Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese" dhe në aneksin II të këtij vendimi.

- Për sa propozohet nga OSSH sh.a., vlerësohet se ndryshimet janë në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", nenit 18, pikës 2, ku parashikohet, se: "Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, me kërkesë të një prodhuesi të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe në përputhje me kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE, propozojnë si pikë lidhjeje në rrjetin e tyre, pikën që plotëson kushtet më të favorshme për prodhuesin e energjisë së rinovueshme nga pikëpamja e kostos dhe e largësisë nga rrjeti dhe garanton qëndrueshmërinë e rrjetit dhe sigurinë e tij, për pasojë vlerësohet se kjo ndarje e propozuar nga shoqëria duhet, gjithashtu, të integrohet dhe të jetë pjesë e "Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes".

- Lidhur me propozimin e OSSH sh.a., që në pikën 3.5.4 të shtohet: "Vetëprodhuesit" me dokumentacionin përkatës të listuar si më poshtë, me tri nënkategori të ndara sipas fuqisë, konkretisht 0–20 kwp, 20–50 kwp, 51–500 kwp, reflektuar në aneksin III të këtij vendimi, grupi i punës ka vlerësuar pranimin e tij referuar shtesës së reflektuar në paragrafin 1.6, "Kërkesa për lidhje të re", ku kërkesë për lidhje të re paraqesin edhe vetëprodhuesit, si një kategori e posaçme, e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Lidhur me propozimin e OSSH sh.a, që në pjesën IV "Tarifat për lidhjet e reja", paragrafi 4.2, pika 2, "Punimet/shërbimet që do të paguhen nga aplikanti", të hiqet paragrafi: "Koston e pjesës së kabllos më shumë së 50 ml (metër linear), vlera e së cilës do të përcaktohet referuar çmimit mesatar të kësaj kablloje në librat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (klientët e pajisur me matës energjie në boks individual), dhe propozimin që paragrafi "Hapja e kanaleve të kabllove për realizimin e nyjave bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike, që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, mufte etj.), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë dhe sistemet rrugore", ndryshon dhe bëhet: "Pjesa e kabllos më shumë se 50 ml, hapja e kanaleve të kabllove për realizimin e nyjave bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, mufte etj.), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë dhe sistemet rrugore".

- Vlerësohet se ky ndryshim nuk cenon tarifat e përcaktuara më herët në "Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi", për pasojë saktësimi i kësaj dispozite është në përputhje me qëllimin e ndryshimeve të propozuara.

- Në përfundim, përveç sa më sipër analizuar, gjatë vlerësimit të kërkesës së shoqërisë OSSH sh.a. është marrë në konsideratë dhe: i. që shoqëria OSSH sh.a. është subjekti i drejtpërdrejtë përgjegjës për zbatimin e detyrave, afateve kohore dhe procedurave të lidhjeve të reja të përcaktuara në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes; dhe ii. çdo ndryshim i propozuar në procedurat dhe afatet e parashikuara në këtë rregullore të mos sjellë në mënyrë të papërcaktuar dhe në vlerësim të kostove dhe afateve të nevojshme e të arsyeshme për realizimin e kërkesës dhe lidhjes me rrjetin.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin pjesërisht të kërkesës së OSSH sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në "Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Kudo në rregullore dhe anekse ku është përdorur termi "OSHEE" sh.a., do të ndryshohet me "OSSH" sh.a.

- Në pikën 1.3, "Përkufizime", shtohet përkufizimi "Lidhje e përkohshme", me përmbajtje: "Lidhja e përkohshme" është lidhja e përkohshme energjisë elektrike, e cila hapet vetëm për subjekte sezonale për periudha të caktuara, sipas kërkesës së aplikantit, në përputhje me afatet dhe lejen zhvillimore apo lejen e ndërtimit të përkohshme dhe do të ndërpritet me kërkesë të subjektit ose nëse objekti është demontuar, sipas akteve të organeve ligj zbatuese për administrimin e territorit.

- Në pikën 1.3, "Përkufizimi", paragrafi 3 "Tarifa për aplikim" ndryshohet me përmbajtje: "Tarifa për aplikim" (pagesa) është pagesa që kryhet nga aplikanti në kohën kur aprovohet preventivi për lidhje, i cili mbulon studimin e pranueshmërisë së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes dhe përgatitjen e dokumentacionit për hartimin e marrëveshjes së lidhjes."

- Pika 2.1.1 ndryshon dhe bëhet: "Aplikimi për lidhje të re të përkohshme në sistemin e shpërndarjes mund të kryhet nga:

a) Çdo person fizik apo juridik, apo përdorues ekzistues i tillë që ushtron aktivitet sezonal të përkohshëm, në përputhje me një leje zhvillimore apo leje ndërtimi të përkohshme, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në aktmarrëveshjen ndërmjet përdoruesit të përkohshëm dhe OSSH sh.a.

b) Tarifat që do të paguhen për lidhjen e re të përkohshme do të jenë të njëjta me tarifat e miratuara në rregullore, referuar fuqisë së instaluar të kërkuar.

c) Pezullimi apo mbyllja e kontratës për lidhjen e re të përkohshme do të kryhet me të njëjtën procedurë që parashikon kontrata e furnizimit me energji elektrike ose rastet kur ka përfunduar leja zhvillimore/e ndërtimit të përkohshëm të lëshuar nga organet kompetente apo jemi në kushtet e demontimit të objektit nga organet ligj zbatuese.

- Në pikën 1.6, "Kërkesa për lidhje të re", shtohet germa "dh", "Vetëprodhuesit".

- Paragrafi 1.11, "Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike të objektit të aplikuesit", germa "e" shtohet fjalia: "Me anë të vetëdeklarimit, apo dokumentacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm prej tij ose paraqitjes së dokumentacionit që kërkohet sipas legjislacionit në fuqi."

- Paragrafi 1.12, "Mënyra e komunikimit", do të shtohet fjalia: "Aplikimi mund të bëhet edhe *online* nëpërmjet aplikacionit në faqen zyrtare të shoqërisë OSHEE Group sh.a, si dhe nëpërmjet aplikacionit mobile".

- Pjesa II, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikimin e një lidhje të re", paragrafi 2.1, "Fuqia e instaluar 0–20 kw", hiqen pikat 4, 5 dhe 6 dhe zëvendësohen me "4. Vetëdeklarim nga aplikanti apo çdo dokumentacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm prej tij" (sipas aneksit I të këtij vendimi).

- Pika 4 do të hiqet edhe në paragrafin 2.2, paragrafin 2.3 dhe në paragrafin "Për lidhje të reja në TM".

- Paragrafi për lidhje e reja në TM do të numërtohet 2.4.

- Pjesa III "Procedurat e aplikimit për një lidhje të re", paragrafi 3.1.1, germa "a" do të bashkohen pikat "i" dhe "ii" në vetëm "i", e cila ndryshon dhe bëhet: "i. jo më shumë se 20 ditë pune."

Po në paragrafin 3.1.1, germa "c", "Llogarit kostot për lidhjen e re" shtohet me fjalinë: "Pagesa e preventivit duhet të shlyhet nga aplikanti brenda 7 ditëve pune nga marrja e njoftimit. Në rast të kundërt, aplikimi refuzohet, dhe duhet të riaplikohet".

- Paragrafi 3.5, "Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese", ndryshon dhe ndahet në pikat 3.5.1, "Burimet gjeneruese hidro", pika 3.5.2, "Burimet gjeneruese fotovoltaike" dhe pika 3.5.3, "Burimet gjeneruese eolike" (sipas aneksit II të këtij vendimi).

- Shtohet pika 3.5.4 "Vetëprodhuesit", me dokumentacionin përkatës të listuar në tri nënkategori të ndara sipas fuqisë 0–20 kwp, 20–50 kwp dhe 51–500 kwp (sipas aneksit III të këtij vendimi).

- Pjesa IV "Tarifat për lidhjet e reja", paragrafi 4.2 "Punimet/shërbimet që do të paguhen nga aplikanti", pika 2, do të hiqet paragrafi: Koston e pjesës së kabllos më shumë së 50 ml (metër linear), vlera e të cilit do të përcaktohet referuar çmimit mesatar të kësaj kablloje në librat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (klientët e pajisur me matës energjie në boks individual). Paragrafi "Hapja e kanaleve të kabllove për realizimin e nyjave bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, mufte etj.), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë dhe sistemet rrugore", ndryshon dhe bëhet: "Pjesa e kabllos më shumë se 50 ml, hapja e kanaleve të kabllove për realizimin e nyjave bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, mufte etj.), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë dhe sistemet rrugore.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

ANEKSI I – **Forma e vetëdeklarimit**

**Aplikim për lidhje të re/shtesë fuqie/transferim kontrate 0–20 kw**

Të dhënat personale/shoqërisë
Emri ……..
Atësia……..
Mbiemri……
Nr. i dokumentit të identifikimit ID ……..
NUIS……..
Adresa e
objektit ……
……

Nr.
telefoni ……
……
E-
mail : ……
……

Në rast shtese fuqie/transferim kontrate (kodi i kontratës)……
Kategoria/subjekti (familjare/privat/ambient i përbashkët) .....……
Fuqia e kërkuar …….
Fuqia e instaluar……

Referuar "Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, pika 1.11, "Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike të objektit të aplikuesit":
Unë _____ deklaroj që mbikëqyrjen e të gjitha instalimeve të brendshme dhe tokëzimin e objektit i kam bërë me inxhinier elektrik/studio (emër, mbiemër, nr. licence, nr. ID) konform kushteve teknike dhe legjislacionit në fuqi.

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive ligjore që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit nr. 9887, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", autorizoj me vullnetin tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, në përputhje me detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

_____ _____
Nënshkrimi i deklaruesit Data e nënshkrimi

ANEKSI II – **3.5 Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese**
**- Pika 3.5.1 "Burimet gjeneruese hidro"**
1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (formulari i aplikimit).
2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (kartë identiteti).
3. Genplan i vendosjes së objektit.
4. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.
5. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
6. Projektin e plotë të nyjës, se si do të lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
7. Kopje të licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
8. Kontrata energjisë elektrike për nevojat vetjake.
9. Kontrata e koncesionit (ose miratim nga Ministria) për ndërtimin e burimit gjenerues.
10. Fuqia maksimale e gjeneruar aktive dhe reaktive.
11. Skema principale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.
12. Tipi i gjeneratorit sinkron dhe parametrat e tij.
13. Parametrat kryesorë të transformatorit të fuqisë.

- **Pika 3.5.2, "Burimet gjeneruese fotovoltaike"**
1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (formulari i aplikimit).
2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (kartë identiteti).
3. Genplan i vendosjes së objektit.
4. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.
5. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
6. Projektin e plotë të nyjës, se si do të lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
7. Kopje të licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
8. Kontrata e energjisë elektrike për nevojat vetjake.
9. Kontrata e koncesionit (ose miratim nga ministria) për ndërtimin e burimit gjenerues.
10. Fuqia maksimale e gjeneruar.

11. Skema principale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.

12. Parametrat kryesorë të transformatorit të fuqisë.

13. Manualet dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, siç janë: panelet, inverterat, kabllot etj.

**- Pika 3.5.3, "Burimet gjeneruese eolike"**

1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (formulari i aplikimit).
2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (kartë identiteti).
3. Genplan i vendosjes së objektit.
4. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.
5. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
6. Projektin e plotë të nyjës, se si do lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
7. Kopje të licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
8. Kontrata e energjisë elektrike e nevojave vetjake.
9. Kontrata e koncesionit (ose miratim nga Ministria) për ndërtimin e burimit gjenerues.
10. Fuqia maksimale e gjeneruar.
11. Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.
12. Parametrat kryesorë të transformatorit të fuqisë.

ANEKSI III – **3.5.4 Vetëprodhuesit me dokumentacionin përkatës të listuar si më poshtë me tri nënkategori të ndara sipas fuqisë, konkretisht:**

**- 0–10 kwp**

1. Kërkesa.
2. Deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti sipas historikut të dy viteve të fundit ose në rast të mungesës të një historiku, raportin e auditit energjetik të lëshuar nga audituesi i certifikuar së bashku me certifikatën përkatëse dhe propozimin për fuqinë e instaluar.
3. Propozimin mbi modelin e matësit me dy drejtime skema e matjes neto dhe karakteristikat teknike të tij, sipas standardeve të OSSH-së.
4. Relacioni teknik.
5. Kopje origjinale të aktkolaudimit të sistemit, firmosur nga projektues të licencuar për impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues të licencuar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë (kat. NP-lOA), së bashku me konfirmimin e vetëprodhuesit të sistemit PV.
6. Manualet dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, siç janë: panelet, inverterat, kabllot etj.
7. Licenca e inxhinierit projektues, i cili duhet të ketë pikën IOC në licencë për projektim dhe NPIO për zbatim.
8. Kartë identiteti.
9. Numri kontratës ekzistuese të abonentit (pa debi) me fuqi të njëjtë me fuqinë e impiantit vetëprodhues.
10. Dokument pronësie të objektit ku do ndërtohet impianti fotovoltaik.

**- 11–50 kwp**

1. Kërkesa
2. Deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti, sipas historikut të dy viteve të fundit ose në rast të mungesës të një historiku, raportin e auditit energjetik të lëshuar nga audituesi i certifikuar së bashku me certifikatën përkatëse dhe propozimin për fuqinë e instaluar.
3. Projektin e miratuar nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar për lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me Kodin e Shpërndarjes të miratuar nga ERE.
4. Propozimin mbi modelin e matësit me dy drejtime: skema e matjes neto dhe karakteristikat teknike të tij, sipas standardeve të OSSH-së.

5. Relacioni teknik.

6. Kopje origjinale të aktkolaudimit të sistemit, firmosur nga projektues të licencuar për impiant të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues të licencuar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë (kat. NP-lOA), së bashku me konfirmimin e vetëprodhuesit të sistemit PV.

7. Manualet dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, siç janë: panelet, inverterat, kabllot etj.

8. Të dhëna mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matësit të prodhimit të vendosur pas tij.

9. Licenca e inxhinierit projektues, i cili duhet të ketë pikën 1DC në licencë për projektim dhe NPIO për zbatim.

10. Kartë identiteti.

11. Numri kontratës ekzistuese të abonentit (pa debi) me fuqi të njëjtë me fuqinë e impiantit vetëprodhues.

12. Dokument pronësie të objektit, ku do ndërtohet impianti fotovoltaik.

**- 51–500 kwp**

1. Kërkesa.

2. Deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti sipas historikut të dy viteve të fundit ose në rast të mungesës të një historiku, raportin e auditit energjetik të lëshuar nga audituesi i certifikuar së bashku me certifikatën përkatëse dhe propozimin për fuqinë e instaluar.

3. Projektin e miratuar nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar për lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me Kodin e Shpërndarjes të miratuar nga ERE.

4. Propozimin mbi modelin e matësit me dy drejtime skema e matjes neto dhe karakteristikat teknike të tij, sipas standardeve të OSSH-së.

5. Relacioni teknik.

6. Kopje origjinale të aktkolaudimit të sistemit, firmosur nga projektues të licencuar për impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues të licencuar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë (kat. NP-lOA), së bashku me konfirmimin e vetëprodhuesit të sistemit PV.

7. Manualet dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, siç janë: panelet, inverterat, kabllot etj.

8. Të dhëna mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matësit të prodhimit të vendosur pas tij.

9. Licenca e inxhinierit projektues, i cili duhet të ketë pikën IOC në licencë për projektim dhe NPIO për zbatim.

10. Leje nga bashkia për "Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh", VKM-ja nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar.

11. Kartë identiteti.

12. Numri kontratës ekzistuese të abonentit(pa debi).

13. Dokument pronësie të objektit, ku do ndërtohet impianti fotovoltaik.